



RELACIONI JO - TEKNIK

TRAJTIM I MBETJEVE SPITALORE

Subjekti: “JAMARBER GROUP” SHPK

Përgatiti për “GBA STUDIO”:

Msc. Ing.Mjedisi Denisa KOLA

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Denisa Kola', written over a faint circular stamp.



PRRILL 2017

PASQYRA

KAPITULLI I

1.1HYRJE

1.2Pershkrim te metodikes te zbatuar per hartimin e raportit te VNM

1.3Profili i Kompanise

KAPITULLI II

PERSHKRIMI I PROJEKTIT

2.1Qellimi i projektit

2.2Vendndodhja

2.3Te dhena mbi projektin

KAPITULLI III

PERSHKRIMI I MJEDISIT

3.1Karakteristikat e pergjitheshme te mjedisit natyror

KAPITULLI IV

MASAT PER ZBUTJEN E NDIKIMEVE NE MJEDIS

4.1Ajer

4.2Zhurme

4.3Mbetje te ngurta

4.4Ujera

4.5 Plani i monitorimit Ndertim/Operim

4.6 Plani i emergjencave

4.7Masat e ndihmes se pare

KAPITULLI V

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

5.1 Rekomandime

5.2Konkluzione

1.1 HYRJJE

Raporti synon te jape nje informacion te detajuar dhe te besueshem lidhur me ndikimin mjedisor te projektit te propozuar ne perdorimin e tokes, efektet lidhur me ndikimet ne floren, faunen, burimet e ujit, emetimin e gazeve sere ne atmosfere, shkarkimet ne toke, uje, ndotjen akustike, si dhe çdo ndikim social ekonomik ne punesimin lokal, permiresimin e infrastructures dhe ndikimeve te tjera te rendesishme mjedisore ose sociale, perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permisimin e cilesise dhe qendrushmerise se mjedisit nepermjet :

-Marrjes ne konsiderate te çeshtjeve te mjedisit ne fazen e pergatitjes se projektit.

-Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.

-Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit te aktivitetit minerar te prodhimit

te mineralit ndertimor gurit gelqrerore me kariere mbi mjedisin human.

-Analizen e faktoreve pozitive e negative mjedisore, percaktimin e masave zbutese per reduktimine ndikimeve negative.

-Nxjerrjes ne dukje dhe vlersimin cilesor te ndikimeve ne mjedis te projektit.

-Propozime te masave zbutese te ndikimit ne projekt.

Projekti tenton permiresimin e vlerave ekologjike e rikrijuese te territorit, gjate shfrytezimit te tij , si qender rekreative e social- kulturore.

Per kete problem u be mbikqyrja e terrenit ne te gjithe zonen, duke kryer vrojtime te ndryshme , si dhe te biodiversitetit.

Metoda me e pershtateshme per vleresimin e ndikimit ne mjedis u pranua ajo e liste – kontrollit, e cila vendos nga njera ane te gjitha burimet e mundeshme te ndikimeve dhe nga ana tjeter bartesit e ndikimeve , si dhe parashikimin e madhesise se ndikimit. Ne raport jepet statusi i territorit, korniza ligjore e tij, mjedisi biofizik, gjeologjia e rajonit, gjeologjia e zones, hidrogjeologjia dhe veçorite kryesore te morfologjise se rajonit . Mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk eshte i rendesishem vetem per njerezit por eshte thelbesor dhe i nevojshem per te gjitha qeniet ne toke. Njerezit duhet te kuptojne se si perdorimi i burimeve mjedisore dhe perfitimet qe vijne nga ato te mos demtohen por te jete e mundur te perfitohet sot dhe ne te ardhmen. Termi mjedis dhe burime natyrore perdoren shpesh por jo gjithmone me kuptimin e qarte qe i perkufizon . Burimet natyrore i referohen burimeve te tokes, ujerave siperfaqesore dhe nentokesore , ajrit qe rrethon token, çdo gje qe rritet ne toke apo det si dhe burimet qe gjenden nentoke si psh mineralet. Mjedisi eshte me gjithperfshires, cdo gje qe na rrethon.

Thjesht duke perdorur burimet natyrore ne rrezikojme ne mbiperdorimin dhe shterimin e tyre. Shterimi i burimeve natyrore eshte nje nga problemet thelbesor te çrregullimit te mjedisit. Ne te perfshihet shterimi i ujit, mineraleve perfshire dhe lendet fosile si dhe shume burime te tjera. Çdo veprimtari e kryer nga njeriu shoqerohet edhe me impakt ne mjedis. Pra impakti mjedisor i referohet ndryshimit te mjedisit natyror nga aktiviteti njerezor.

Kemi dy tipe te impaktit mjedisor

- Shterimi i burimeve

- Ndotja

Ne menyre qe te shmangen keto probleme njerezimi duhet te mesoj se si te menaxhohen burimet natyrore ne menyre te qendrueshme. Pra zhvillimi i qendrueshem i burimeve

natyrore nuk eshte gje tjeter vecse perdorimi i tyre ne menyre ekonomike nga brezat e sotem per ti len keto burime te perdoren edhe nga brezat qe do te vijne.

Qendrueshmeria perfshin menaxhimin e gjithe perberesve dhe burimeve natyrore e njerezore me qellim qe te pasurohen me kalimin e kohes dhe te sigurohet nje mireqenie per te gjitha. Zhvillimi i qendrueshem nuk i pranon politikat te cilat cojne ne uljen e bazes prodhuese dhe lene gjeneratat e ardhshme me prespektiva me te ulta (te varfera) dhe/ose rreziqe me te medha se te tonat. Teknologjite qe kontribuojne ne zhvillimin e qendrueshem perfshijne kontrollin e ndotjes, prodhimin e energjise se riciklueshme, rikuperim burimesh dhe riciklim, menaxhim burimesh dhe kerkime shkencore. Problemet mjedisore ne vendin tone lidhen me ndotjen e ajrit ne qytet kryesore , ndotja e ujit e cila vjen nga shkarkimi i ujerave te ndotura pa u trajtuar fillimisht dhe mbetjet urbane te cilat jo te gjitha depozitohen ne vendet e caktuara.

Pasqyra e te dhënave kryesore

Projekti: Trajtim i mbetjeve spitalore

Me vendndodhje: Ne Lagjen Popullore, Shijak, Durres

Kompania zhvilluese: "JAMARBER GROUP" sh.p.k

Pergatiti raportin : "GBA" Studio sh.p.k

1.2 Pershkrim i metodikes te zbatuar per hartimin e raportit te thelluar te VNM

Raporti i vleresimit te ndikimit ne mjedis hartohet me kerkese te shoqerise "JAMARBER GROUP" sh.p.k per aplikimin prane MM-it per marrjen e Lejes Mjedisore per zhvillimin e aktivitetit "Trajtim i mbetjeve spitalore". Raporti i Thelluar i VNM lidhet me aktivitetin e trajtimit te mbetjeve spitalore te propozuar per tu realizuar ne zonen kadastrale Nr. 3369, pasuria Nr. 146/18, rruga Brigada e 10 Sulmuese, Lagjia Popullore, Shijak, Durres.

1.3 Profili i Kompanise

Subjekti i cili do te zhvilloj aktivitetin " Trajtim i mbetjeve spitalore" eshte **JAMARBER GROUP sh.p.k** i regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me date 15-03-2017 dhe themeluar me date 13-03-2017 me numer NIPTI **L71515507M** , forma ligjore **SHPK**. Subjekti do te zhvilloj aktivitetin e trajtimit te mbetjeve spitalore ne Shijak, Durres .

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

2.1 Qëllimi i projektit

Qëllimi i projektit të propozuar është të identifikoj efektet e mundshme në mjedis gjatë funksionimit. Marrja e masave të domosdoshme për minimizimin dhe parandalimin e efekteve të krijuara në mjedis gjatë funksionimit nga aktiviteti i trajtimit të mbetjeve spitalore. Marrja e masave të domosdoshme për minimizimin dhe parandalimin e efekteve të krijuara në mjedis nga aktiviteti i këtij objekti, si dhe të lihen detyra për investitorin në shërbim të komunitetit dhe me gjere.

2.2 Vendndodhja e zonës së projektit

Vendi i ushtrimit të këtij aktiviteti ndodhet në Shijak, Durrës, në Lagjen Popullore, rr. Brigada e XI sulmuese.



Koordinatat GAUS KRUGER

E	N
4380678.82	4579768.19

2.3 Te dhëna mbi projektin

Ky projekt në vlerësim “Asgjesim i mbetjeve spitalore me metoden e trajtimit me presion me avull- autoclaves Model Irop” propozon ndertimin e një qendre grumbullimi dhe trajtimi të mbetjeve spitalore sipas kategorive perkatëse të mbetjeve spitalore sipas kategorive perkatëse të mbetjeve që trajtohen fizikisht me autoclave (metoda presion-avull). Ky projekt propozon instalimin e këtij impianti në Lagja Popullore, Rr. Brigada e XI Sulmuese, Shijak, Durrës, në ambjentet e brendshme të një magazine ekzistuese e cila

do te rikonstruktohet dhe do te pajiset me te gjitha instalimet e nevojshme per nje funksionim sa me optimal te kesaj qendre, duke shmangur ne cdo rast ndikimin ne nivele te ndjeshme dhe shqetesuese per komunitetin perreth zones.

Ky project propozon nje nga pese metodat alternative VKM Nr. 798, date 29.09.2010 per miratimin e rregullores "Per administrimin e mbetjeve spitalore" specifikohet ne Shtojcen Nr.3 pika 1, me trajtim fizik (Autoklave-presin-avull).

Pra ne menyre te permbledhur do te trajtohen keto mbetje kryesore, mbeshtetur ne klasifikimin e tyre sipas Vendimit Nr.99 date 18.02.2005 "Per miratimin e katalogut shqipetar te klasifikimit te mbetjeve" qe jane pjese ne Shtojcen 1 pika 18- Mbetje nga kujdesi shendetesor njerezor ose shtazor dhe kerkime qe lidhen me to (me perjashtim te mbetjeve te guzhinave, restoranteve qe nuk lidhen drejtperdrejt me kujdesin shendetesor), kodi 18 01 01 (bisturi, shiringa dhe instrument ate mprehta petvec 18 01 03 dhe kodi 18 01 02 pjese te trupit dhe organe, perfshire qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut pervec 18 01 03).

PERSHKRIMI I AUTOKLAVES

Kjo metode me autoklave vleresohet sin je metode e zakonshme dhe shume e perdoreshme vitet e fundit ne vende te ndryshme te BE te cilet kane zevendesuar perdorimin e inceneratoreve. Kjo metode eshte perdorur shume vite me pare per te disinfektuar materialet mjekesore per tu riperdorur perseri. Ne ndryshim me inceneratoret kjo metode vepron mbi mbetjet spitalore ne temperature te larta aq sa te srrihet disinfektimi i ketyre mbetjeve sipas llojit dhe infeksioneve qe mund te permbajne, por jot e digjet dhe te emetoj substance ndotese ne ajer siç jane dioksine, furan etj.

Procesi i punes se nje autoklave eshte i thjesht dhe pa emetime ne ajer, avujt e ujit qe prodhohen te kombinuara me lageshti, nxehtesi dhe presion per te eliminuar mikroorganizmat. Ky process eshte perdorur dhe me heret dhe vazhdon te perdoret edhe sot sin je pajisje per te disinfektuar materialet dhe pajisjet spitalore. Ne ditet e sotme kjo metode perdoret per te trajtuar mbetjet bio-spitalore. Shume prej mbetjeve spitalore jane te ndotura nga cdo lloj patogjeni si bakterie, viruse, parasite, etj te cilet i marrin dhe instrumentat qe perdoren.

Perdorimi i autoklaves per trajtimin e mbetjeve spitalore eshte vleresuar si metoda me e paster ku pasi trajtohen mbetjet depozitohen ne kuti te mbyllura dhe hermetike apo qese sipas ngjyrave perkatese per tu depozituar ne vendgrumbullimin (lanfillin) e zones perkatese. Autoklava nuk e perzien lenden apo ta rretulloj ate per te mundesuar nderfutjen e avujve te nxehte, pasi kjo arrihet edhe pa u perzier me njeri-tjetrin, arrihet qe keto mbetje te jene te pidentifikueshme si dhe ulet volumi i tyre rreth 70-80%. Autoklava eshte metode e aprovuar dhe eshte e pranuar nga 50 shtete sin je metode me kosto te ulet ekonomike dhe ambjentale per te trajtuar mbetjet spitalore. Kjo metode vleresohet sot si alternative shume e pershtatshme per trajtimin e mbetjeve spitalore te zonave te vogla locale e cila arrin te trajtoj nga 4 deri ne 400 kg ne dite.

3.1 Impaktet e mundshme positive te autoklaves

Impaktet e mundshme positive nga instalimi i kesaj njesie, autoklave perfshine:

- Nje qender bashkohore pa ndikim ne cilesine e ajerit apo prodhim te ndotesvave si dioksina, dhe furani te cilet jane shkaktari kryesor i semundjeve te rrugeve te frymemarrjes, lindjeve me difekt etj.
- Desinfektimi dhe berja e pa identifikueshme dhe jo e rrezikshme e ketyre mbetjeve spitalore dhe vleresimi i tyre si mbetje te zakonshme urbane pas procesit te trajtimit.
- Dhenia e zgjedhjes per keto lloj mbetjesh pa ndikuar ne parametrat mjedisor.
- Perdorimi i nje metode te re dhe bashkohore dhe te aprovuar nga standartet ISO 2000-9001.
- Trajtimi dhe seleksionimi i mbetjeve me nje metode te domosdoshme dhe jot e rrezikshem per mjedisin.
- Nje experience e re dhe model per rrethet e tjera te Shqiperise.
- Krijimi i mundesive te reja per vende pune.
- Mos perdorimi i hidrokarbureve si lende djegese por i energjise elektrike per funksionimin e autoklavave, ul impaktin ne cilesine e ajerit te zones.
- Nje zgjidhje e drejte dhe komform standarteve te reja te kerkuara dhe mos perdorimi i inceneratoreve pra dhenia e nje zgjidhje "te paster", komform nje vendi qe kerkon te kete zhvillim te qendrueshem.

3.2 Impaktet e mundshme negative te autoklaves

Deri kohet e fundit emetimet e gazeve dhe vecanerisht ndotja nga trajtimi teknologjik i mbetjeve spitalore nuk ka qene i karakterizuar mire. VOC-te jane component te mbetjeve spitalore dhe emetime qe dalin gjate procesit te trajtimit. Nga nje raport studimor i Institutit nacional per sigurine dhe shendetin ne pune u vleresuan emetimet ne lidhje me aerosolet dhe elementet kimik nga alternativat e trajtimit te mbetjeve spitalore. Ku u arrit ne keto perfundime:

- Perqendrimi i formaldehideve ishte me i ulet se nivelet kritike te percaktuara nga OSHA, PEL, ACGIH, me e ulet se vlera e pragut limit por me e larte se rekomandimet e Institutit te siperpermendur.
- Ne autoklave dhe ne sterilizues mikroval, ishin vrejtur gjithashtu edhe acetaldehyde dhe acetone por ne nje perqendrim me te ulet se ai i PEL (Permissible Exposure Limits).
- Ndonjeher u vu re perqendrimi i larte i ammonias i cili nuk clirohet nga trajtimi i mbetjeve spitalore, ai eshte present te pajisjet e autoklaves, clirohet nga rrjedhje apo carje te tubave pra nga mos inspektimi sic duhet i pajisjes.
- Mostrat e metaleve per te tjera pajisje ndodhen ne nivele minimale (shume here me i ulet se nivelet e lejuara) si metalet e meposhtme:
Be, Al, Cr, Mn, Fe, Co, Ni, Zn, Cu, Ag, Hg, Pb, Tl, Ba, Sb, Cd, Se dhe Ac. Pajisjet e pirolizes gjithashtu permbajne sasi te vogla (P) Fosfori.
- Asnje gjurme Klori nuk eshte identifikuar ne ajrin qe cliron autoclave ose pajisjet mekaniko-kimike.
- Cilesia e ajerit ne hyrje eshte testuar per temperature, lageshtine, treguesit e dioksideve te karbonit (CO₂) dhe monokside karboni (CO) dhe ka dale se eshte i pershtatshem pa kalim te nivelit te ketyre treguesve.

Mbetjet e ngurta te shkaktuara nga autoklava ne te shumten e rasteve jane konstatuar sterile.

Disa sisteme i ngjeshin apo grijne mbetjet spitalore si pjese e procesit te trajtimit. Shume agjenci rregullatore nuk e pengojne percaktimin e trajtimit vetem te mbetjeve. Gjithesesi per disa ceshtje te tjera te trajtimit te mbetjeve mund te kerkojne procese shtese. Vecanerisht mjetet e mprehta te cilat mund te perbejne nje rrezik fizik dhe qe duhet qe te shkaterrohen, te ndryshojne formen fizike te tyre. Keto lloj mbetjesh mund te lendojne ose te shkaktojne prerje te medha neqoftese nuk trajtihen dhe hidhen ne zona te percaktuara si vend depozitimi.

Sic eshte permendur me siper shume tipe te mbetjeve klinike jane trajtuar nga autoklava. Gjithashtu mbetjet pas trajtimit jane te pidentifikueshme sidomos kur perdoret copezuesi. Jo cdo lloj mbetje qe prodhohet nga klinikat eshte e trajtueshme me autoklave. Mbetjet patologjike mund te trajtohen me autoklave vetem me disa sisteme hibride autoklavash per vete faktin se keto lloj mbetjesh qe kane nje densitet te ndryshem sic jane kockat dhe indet, etj. Prandaj do te jete e kerkuar qe keto lloj mbetjesh te vecohen ne qese perkatese per te qene te identifikueshme dhe te procedohet ne menyren e pershtatshme te trajtimit te tyre.

Ne kete seksion do te vleresohen perfundimet e vendosjes se mbetjeve spitalore te trajtuara me autoklave, vendepozitimi i mbetjeve te ngurta, i cili do te fokusohet ne largimin e mbetjeve te trajtuara nga pika e grumbullimit te tyre deri ne vendosjen finale ne landfill.

Ky raport do te vleresoi prezencen e agjenteve infektues ne mbetjet e prodhuara, rrezikshmerine e transmetimit te semundjes nepermjet kontaktit direct, aerosolet, ujerat siperfaqesore dhe nentokesore dhe vektoret biologjik etj. Ne nje kuptim te gjere vendepozitimet e mbetjeve te ngurta spitalore mund te shihen sin je “Rezervuar Infeksioni”.

MASAT PAR EVITIMIN APO ZBUTJEN E NDIKIMEVE NE MJEDIS

Ne kemi pranuar sfida qe lidhen me mbrojtjen e mjedisit, bashke ne premisat e tij dhe mbrojtjen e mjedisit te vendit. Duke qene nje industri e madhe ne Shqiperi, ne jemi nje kercenim per ekologjine duke rrezikuar gjendjen e ajrit dhe tokes. Me hyrjen ne BE, ne duhet te perputhemi me normat e IPPC (Direktivat e Integruara te Kontrollit te Parandalimit te Ndotjes) Kompania ne nje menyre te planifikuar dhe te dokumentuar, do te zbatoje kerkesat e kerkuara nga keto direktiva.

Zbatimi i standarteve te mbrojtjes se mjedisit perfshin nje teresi aktivitetesh dhe koordinimesh te mjaftueshme, si dhe ndryshimet ne perceptim, me qellim qe te arrihen standartet e kerkuara. Nje grup menaxheresh, inxhinieresh dhe punetoresh te tjere nga sektore te ndryshem kane punuar ne implementimin e EMS qe prej vitit 2008.

Si nje nevojshmeri per standartin, grupi tashme duhet te perputhet me Ligjin per Mjedisin qe ka si ”mission” mbrojtjen e mjedisit. Ky ligj pranon pergjegjshmerine e kompanise per te prodhuar dhe shperndare bitum dhe gazoil per klientelen e saj ne nje menyre eficiente dhe te sigurte, duke mbrojtur njekohesisht mjedisin. Inxhinieret thone “Ne e kuptojme qe veprimet tona kane ndikime te pashmangshme ne mjedis. E kemi per detyre qe t’i pakesojme sa me shume qe te jete e mundur keto efekte, si dhe te permiresojme ne menyre te vazhdueshme performancen tone”.

Ne veme ne praktike nje numer parimesh ne perputhje me te gjitha legjislacionet, rregullat dhe lejet e aplikueshme te mjedisit dhe ne raste te vecanta qe i kane arritur qellimet. Ne do vazhdojme perpjekjet tona per te kontrolluar dhe pakesuar ndotjen dhe per te arritur objektiva te qarta dhe te matshme te mjedisit. Grupi gjithshu po angazhohet qe te reduktoj energjine e konsumuar si dhe humbjet gjate transportit, gjersa kerkon te reduktoj konsumimin e materialeve ne te gjitha operacionet, riperdorimin dhe per te ndihmuar ne riciklimin e tyre. Kompania gjithshu po promovon perdorimin e praktikave te miremenaxhimit te mjedisit nga kontraktuesit i tij, nepermjet nje marreveshjeje te qendrueshme se bashku me suportin e vazhdueshem ndaj grupeve, nepermjet Karteles se Pergjegjshmerise Sociale te Kompanise, per te mbrojtur mjedisin si dhe te zhvilloje nje marredhenie te qendrueshme me komunitetin lokal.

CESHTE MJEDISORE	NDIKIMI NE MJEDIS	MASAT PARANDALUESE
Ndotja e ajerit	Ndikimi ne mjedis i pluhurave do te jete minimal pasi kapaciteti i punimeve te rikonstruksionit te godines do te jene mesatare si dhe ndikimi i tyre ne mjedisin e banuar do te jete i pa perfillshem psi nuk ka objekte banimi perreth.	Do te sigurohet lagia periodike dhe e vazhdueshme e sheshit te ndertimit sidomos gjate stines se veres. Rrethimi i sheshit te punimeve per te mundesuar berjen e barrierave per kapjen e plurave, si dhe moslargimi i bemesise.
Zhurmat	Zhuramt do te shkaktojne keto efekte kryesore qe jane irritim, rritje e stresit tek punonjesit deri te demtimi i degjimit si dhe prishje e qetesise se zones perreth por ne nivele minimale.	Mjetet dhe pajisjet qe do te perdoren gjate fazes se rikonstruksionit do te jene ne kushte optimal si dhe do te mirembahen me ane te kontrollit periodic te tyre per te shmangur ndotjen akustike nga zhurmat ne mjedis komform Udhezimit Nr.6527 date 24.12.2004 "Mbi vlerat nga shkarkimet e gazeve dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe menyra e kontrollit te ture".
Mbetjet e ngurta	Mos menaxhimi i duhur i ketyre mbetjeve mund te sjell krijimin e zonave si burim infeksionesh, shtim te pranise se infeksioneve etj. Kjo do te ndikonte ne imazhin e zones perreth e cila eshte nje zone e paster larg vendepozitimeve te	Menaxhimi i ketyre mbetjeve do te behet komform kushteve qe do te percaktohen nga inspektoret e mjedisit si dhe te njesise vendore per te minimizuar sasine e mbetjeve qe pradhohen gjate fazes se rikonstruksionit.ku te shihet

	mbetjeve urbane. Mos depozitimi ne vende te pershtatshme dhe komform kushteve teknike te tyre do te sjell impact ne kanalet e drenazhimit te zones perreth te cilat kane sherbyer per vaditje dhe shmangien e permbytjeve.	e nevojshme shume prej ketyre mbetjeve do te riperdoren per sistemimin e zones ku do tem billet bimesi, pjesa tjeter se bashku me materialet inerte jot e rrezikshme do te largohet per ne vendepozitimin e mbetjeve inerte pasi te jete marr aprovimi nga Bashkia.
Ujerat e ndotura urbane	Stuhite me prurje te mbedha shiu mund te shkaktojne bllokim te kanaleve te drenazhimit te zones nga mbetjet inerte te cilat do te sillnin joefektivitet te tyre deri ne permbytjen e zones. Nese nuk gjendet nje zgjidhje e pershtatshem per ujerat e zeza qe mund te prodhohen nga punonjesit mund te behen nje problem serioz per zonen ne vleresim dhe per vete punonjesit.	Mbetjet e ndertimit nuk do te depozitohen ne hapsira te hapura dhe te pambrojturanga efektet natyrore sic jane rreshjet e shiut dhe era. Per sa i perket ujerave te zeza do te montohen rulota te levizshme WC per tu perdorur nga punonjesit e ndertimit si dhe shkarkimi I tyre do te behet ne piken qe do te percaktohet nga autoritetet pergjegjese si dhe shmangia e depozitimit te tyre ne perrua apo lum, pa u trajtuar.

4.5 Plani i monitorimit Ndertim/ Operim Plani i monitorimit gjate fazes se ndertimit

Te gjitha masat qe permenden ne seksionet e vleresimit te impakteve ne mjedis gjate fazes se ndertimit do te zbatohen nga investitori, (kontraktori i punemeve te ndertimit). Kontraktori/inxhinieri do te jete pergjegjes qe te siguroje qe masat jane implementuar komform kushteve teknike perkatese si dhe do te pergatitet nje raport mujor per tu dorezuar ne agjencine Rajonale te Mjedisit, Qarku Durres, per tu vleresuar nga specialistet ecuria dhe efektiviteti i ketyre masave konkrete qe do te merren nga investitori, zbatimi me perpikmeri i Udhezimit te "Vetmonitorimit".

Te gjitha keto te dhena do te dorezohen cdo tre muja prane ARM-se si dhe do te publikohen ne faqen e tyre te Web per te qene transparent per palet e interesuara.

Ky raport monitories do te jete i permbledhur ku te specifikohen qarte te dhenat dhe metodat e perdorura per monitorimin si dhe te shoqeruara me te dhenat e regjistruara, ky monitorim do te realizohet nga shoqeri te akredituara per te realizuar planin e monitorimit, ky plan do te permbaje dhe:

- Pershkrimin e projektit (te dhenat specifike te autoclaves, lloji dhe tipi I saj dhe katalogu I mbetjeve qe trajtohen nga kjo pajisje);
- Te dhenat specifike per instrumentat dhe normat e perdorura per cdo tregues te monitoruar si dhe shkalla e instrumentave individual;
- Raport i detajuar i te dhenave te lexuar;
- Krahasimi i ketyre te dhenave me te dhenat limit;
- Konkluzione dhe rekomandime.

Plani i monitorimit gjate fazes se operimit

Plani i monitorimit dhe menaxhimit do te implementohet gjate fazes se ndertimit dhe projektimit:

- Te gjitha masat lehtesuese te permendura me siper do te zbatohen nga investitori i cili do te zbattoj projektin;
- Cdo prodhues i mbetjeve duhet te respektojte me perpikmeri procesin e seleksionimit te mbetjeve si dhe paketimit te tyre komform Vendimit Nr. 798, date 29.09.2010 ku te ndahen sipas klasifikimit perkates;
- Nuk do te pranohen mbetje radioactive apo kimike te cilat nuk trajtohen ne kete process;
- Do te mbahen regjistra per cdo mbetje qe do te hyj ne qendren e trajtimit. Operatori siguron qe te gjitha materialet qe hyjne dhe dalin nga impianti te kontrollohen e te regjistroheshen, dhe te mbahen regjistra me informacionin e meposhtem:
 - a. Specifikime per volumin dhe permbajtjen e materialeve qe hyjne ne impiant nga cdo makine;
 - b. Emertimin e personit, aktiviteti i te cilit ka prodhuar mbetjet;
 - c. Furnizuesi;
 - d. Data e dorezimit dhe nisjes se materialeve (mbetjeve spitalore);
 - e. Targa e mjetit;
 - f. Emir i personit qe ka inspektuar mbetjet.
- Mbetjet qe nuk pranohen nga punonjesi i impiantit, regjistrohen me te njejtat detaje si ne paragrafin me siper. Regjistrimi permban emrin dhe adresen e vendepozitimit tjeter, ku dergohen keto mbetje. Regjistri i mbetjeve dhe materialeve, te cilat dalin nga impianti qer qellim perdorimi, perfshin informacionin e meposhtem: emrin dhe adresen e subjektit ku do te perdoren materialet, si dhe lloji i materialit, cdo lloj pagese apo tarife e kryer per materialin;
- Squfuri ne permbajtjen e vajrave duhet te jete me pak se 2 % edhe pse ai nuk vleresohet si rrezik per mjedisin e punes;
- Monitorimi i treguesve te mjedisit do te realizohet komform kushteve qe do te percaktohen nga MMPAU dhe MSH;
- Masa per mbrojtjen kundra zjarrit duhet te merren perte shmangur aksidente te mundshme ne kete qender trajtimi.

4.6 Plani i emergjencave

Plani i emergjencave eshte i domosdoshem pasi ne kete faze vleresohet ndikimi iprojektit gjate ndertimit dhe funksionimit nga rreziqet e mundshme. Faktoret qe ndikojne jane:

- Termite
- Renia e zjarrit
- Permbytje
- Mungesa e komunikimit
- Pikime te mbetjeve kimike
- Mungesa e organizimit structural
- Shqetesim civil

Menaxhimi i emergjencave eshte gjithashtu kritik per planifikimin, parandalimin, responsibilitetin dhe rimbulimin nga impaktet e mundshme te ketyre ngjarjeve.

Procesi I planifikimit te emergjencave eshte shume specific dhe I ndryshem ne varesi te tipit te funksionimit, pozicionit gjeografik etj. Ky Plan do te jete identifikimi I rreziqeve potenciale ose rreziqeve te facilitetit, organizimit dhe bazat e operimit te faktoreve posht permendur.

Plani i Emergjencave duhet te dokumentohet dhe te perfshij gjithë zonen e permendur me siper per zbatimin e ketij projekti:

- Plani duhet te idetifikoje personat pergjegjes per zbatimin e tij. Personat pergjegjes duhet te mbajne dokumentacionin e azhornuar si dhe te pershtatshem per te gjithë punonjesit;
- Plani duhet te paraqese veprimet e pergatitura qe duhet te merren ne rastin e emergjencave specifike sipas faktoreve perkatese;
- Duhet te pefshije veprimet qe duhen marre ne rastet e renies se zjarrit, termateve etj. Duhet te pergatitet nje planimetri e detajuar dhe e pajisur me sinjalistikat perkatese ku te percaktohen qarte daljet per emergjenca si dhe numri i personit te kontaktit nese do te kete te lenuar (Nr. i zjarrefikses. Policise, Ambukances etj);
- Pergatitja e punonjesve per situatë te tilla si dhe sensibilizimi I tyre me rreziqet e mundshme gjate operimit;
- Akti teknik per MKZ duhet te realizohet vazhdimisht dhe ne periudha te caktuara p.sh cdo tre here ne vit;
- Plani duhet te perfshije kontroll periodic te pajisjeve kundra zjarrit;
- Plani duhet te jete specific dhe i qarte ne lidhje me masat konkrete pasi ka ndodhur emergjenca.

4.7 Masat e ndihmës së parë

Në rast renie zjarri të thithjes së avujve paraqitet irritimi i hundës dhe fytit, pra kollitja. Largimi në ajër të i pastër i personave te pranishem, e në rast të komplikacioneve të jepet ndihma e parë,e pastaj të kërkohet ndihma mjekësore.

5.1 Rekomandime

- Respektimi i Plan Menaxhimit Mjedisor qe do te percaktohet ne menyre specifike nga shoqeria perkatese.

- Rehabilitimi i zones oas zbatimit konkret te projektit dhe shmangia e degradimit te mjedisit natyror te zones perreth.
- Te respektohet habitati i zones perreth pa ndikuar ne ciklin e tyre te jeteses ne harmoni me natyren.
- Perdorimi me eficence i energjise elektrike dhe ujit si dhe hartimi i nje plani per perdorim te pajisjeve me eficence energjitike si dhe i burimeve te rinovueshme per prodhimin e avujve te ujit.
- Marrjen e masave per te parandaluar perzierjen e mbetjeve te trajtuar me ato te patrajuara.
- Instalimin e nje impianti per trajtimin e ujerave te ndotur conform legjislacionit ne fuqi si dhe monitorimi i tyre per te shmangur ndotje te ujerave prites.
- Monitorim te vazhdueshem te treguesve mjedisor per te shmangur mbi kalim te normave te shkarkimit per kete vepriptari prandaj duhet te konsultohen me institucionet pergjegjese.
- Kontenieret e mbetjeve te rrezikshme spitalore duhet te permbushin kerkesat e percaktuara nga Organizata e Kombeve te Bashkuara, te etiketohen ne perputhje me shtojcen 2.B te rregullores dhe te magazinohen ne menyre te tille qe te lejojne hyrjen per qellime inspektimi.
- Kontenieret duhet te jene specific sipas llojit te mbetjeve dhe ne perputhje me katalogun shqipetar perkates per paketimin e ketyre mbetjeve.
- Automjetet qe transportojne mbetjet sitalore infektuese duhet te permbushen kerkesat e shtojces 4 te kesaj rregulloreje.
- Ne rast se ne vendin e prodhimit apo gjate transportimit, mbetjet spitalore te rrezikshme, ne menyre te vullnetshme apo te pavullnetshme perzihen me mbetje spitalore te parrezikshme, keto mbetje spitalore do te trajtohen si mbetje te rrezikshem dhe do te dergohen ne kete qender komform kushteve teknike te saj.
- Kur mbetjet spitalore do te magazinohen ne qender duhet te permbushen kerkesat e meposhtme:
 - Te lejohet hyrja vetem e personave qe kane kualifikim per te administruar mbetjet spitalore;
 - Te tregohet kujdes per sigurine e konteniereve, te parandalohen rrjedhjet, te sigurohet mbrojtja nga uji , shiu dhe era, si dhe te shmangen kushtet e inkubimit mikrobik dhe te dekompozimit te tyre. Mbetjet njerezore, shtazore apo te ndonje gjallese tjeter te magazinuar per me shume se 24 ore, por gjithsesi me pak se 48 ore nga ambalazhimi, duhet te ruhen ne frigorifer ose hapsire frigoriferike qe perdoret vetem per mbetjet spitalore ne nje temperature jo me te larte se 10 ° C;
 - Te jene ndertuar me material te qendrueshme qe pstrohen lehtesisht, qe nuk lejojne depertimin e lengjeve dhe te jene rezistente ndaj parazitëve;
 - Te mbahen paster, ne kushte te mira sanitare, dhe ne gjendje te mire funksionale;
 - Mbetjet te jene te etiketuara ne menyre te dukshme me simbolin nderkombetar te bio-rrezikshmerise te paraqitur ne shtojcen 2.A te rregullores dhe me njoftime te rrezikut ne dyer, porta ose mbulesa, frigorifere dhe kontenier te tjere qe tregojne perdorimin e magazines per mbetje spitalore dhe se hyrja e personave te paautorizuar eshte e ndaluar;

- Sistemet e kullimit te dyshemese se magazines duhet ti mundesojne shkarkimet durekt ne nje system kanalizimesh sanitare per asgjesimin e ujerave te ndotura, ne perputhje me Ligjin Nr.9115, date 24.07.2003 “Per trajtimin mjedisor te ujerave te ndotur” ose ne nje impiant grumbullimi qe parandalon derdhjen e lengjeve dhe renien ne kontakt me mjedisin;
- Te respektoje kushtet dhe normat e shkarkimit ne ajer edhe pse nuk jane te percaktuara ne menyre te qarte per kete lloj veprimtarie ne VKM Nr. 435, date 12.09.2002 “Per miratimin e normave te shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise”.
- Pergjegjesi i autoklaves duhet te kryej monitorime dhe regjistrime te vazhdueshme te treguesve te saj si temperature, presioni etj si dhe te ruaj te dhenat e monitorimeve te kryera per nje periudhe shtatevjecare.
- Mirembajtja dhe gjelberimi ne menyre te vazhdueshme te mjediseve perreth aktivitetit duke shmangur nje imazh ten je zone te brakisur dhe ne kundershtim me vete qellimin e saj.
- Respektimi i Kodit te punes dhe plani i emergjencave si dhe i rregulloreve te brendshme te vete veprimtarise.

5.2 Konkluzione

- Me e rendesishme per tu theksuar ne perfundim te ketij raporti eshte se ai do ti vije ne ndihme mbrojtjes se mjedisit
- Teritori i JAMARBER GROUP nuk ka ndonje status te veçante qe pengon punimet ne kete aktivitet.
- Me masat qe do te merren aktiviteti nuk do te kete ndikime negative ne toke dhe nuk do te ndikojne ne ujrat siperfaqesore e nentokesore.
- Hartimi dhe zbatimi i projektit te trajtimit te mbetjeve spitalore nuk do te kete ndonje pasoje negative te mundeshme ne mjedisin e zones mbasi objekti eshte vendosur ne nje teren pa ndonje zhvillim te dukshem te pyjeve apo drureve frutore, mbasi mungon vegjatacioni (subjekti do te mbjell vete nje parcele me bimesi te zones).
- Ndikim te priteshem do te kete vetem ne ndryshimin e pjeseshem ne toke ,te peisazhit te zones qe me masat qe jane parashikuar ne terren do te zbusin kete fenomen dhe do te çojne ne permiresimin e metejshem te tij.
- Vendin e siperfaqes se zhveshur do ta zeje nje siperfaqe e pyllezuar.
- Trajtimi i mbetjeve spitalore eshte rezultat i rritjes se kerkesave te tregut.
- Aktiviteti i trajtimit te mbetjeve spitalore ne objekt do te kete inpakt pozitiv mbasi do te ndihmoje ne hapjen e vendeve te reja te punes.

